



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERV OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivery	20.05	1	viti god year
Organ /Njesia Org./Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Priloz Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDINSHUK	2513/2021		115



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.178/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.178/2021 të datës 23.03.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë Lagjja "Nic" Rr. Bekim Fehmiu – Çagllavicë –Prishtinë, kundër organit të punësimit Zyra e Presidentit, në çështjen juridike "Largim nga Shërbimi Civil", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 47 dhe nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur me datë 20.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.178/2021 e datës 23.03.2021 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokoli 09/08 i datës 22.02.2021 i Komisionit Disiplinor *ad hoc* për Nivelin e Lartë Drejtues pranë Zyrës së Presidentit.

A r s y e t i m

Ankuesi Sekretar i Zyrës së Presidentit, me datë 23.03.2021 ka parashtruar ankesën me numër protokoli 1328/2021 të regjistruar me numër A.nr.178/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokoli 09/08 të datës 22.02.2021 të Komisionit Disiplinor *ad hoc* për Nivelin e Lartë Drejtues pranë Zyrës së Presidentit, përmes të cilit ankuesit i është shqiptuar masa disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil".

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, me datë 29.03.2021, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit të Zyra e Presidentit të Republikës së

Kosovës. Këshilli me datë 06.04.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave fillimisht ka konstatuar se ankesa i plotëson kushtet për shqyrtim në përputhje me nenin 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe për të vendosur në mënyrë meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 1328/2021 të regjistruar me numër A.nr.178/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.Prot:09/08 të datës 22.02.2021 të Komisionit Disiplinor *ad hoc* për Nivelin e Lartë Drejtues pranë Zyrës së Presidentit; Vendimin A.nr.430/2020 të datës 16.02.2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokoli 01 të datës 06.01.2021 për Themelimin e Komisionit Disiplinor *ad hoc* për Nivelin e Lartë Drejtues; Vendimin me numër protokoli 03 të datës 20.01.2021 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Vendimit Nr.01/2021; Vendimin me Nr.Prot:1336/1 të datës 22.12.2020 të U.d Presidentes së Republikës së Kosovës; Ankesën e datës 21.12.2020 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.Prot:1336 të datës 15.12.2020 të U.d Presidentes së Republikës së Kosovës; Vendimin me Nr.Port:733/1 të datës 29.06.2018 për Emërimin e Sekretarit të Zyrës së Presidentit; E-mailin e datës 21.01.2021 nga F.P për M.H; E-mailin e datës 09.11.2020 nga F.P; Kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore me Nr.Port:1335 të datës 15.12.202; Shkresën e datës 03.02.2021 nga U.d Presidentja e Republikës së Kosovës; Dëshminë e datës 22.02.2021 në emër të ankuesit; Ekstraktin e Procesverbalit me Nr.Prot:09/2 të datës 26.01.2021 të Komisionit Disiplinor; Ekstraktin e Procesverbalit me Nr.Prot:09/3 të datës 09.02.2021 të Komisionit Disiplinor; Ekstraktin e Procesverbalit me Nr.Prot:09/4 të datës 09.02.2021 të Komisionit Disiplinor; Ekstraktin e Procesverbalit me Nr.Prot:09/5 të datës 10.02.2021 të Komisionit Disiplinor; Ekstraktin e Procesverbalit me Nr.Prot:09/6 të datës 22.02.2021 të Komisionit Disiplinor; Ekstraktin e Procesverbalit me Nr.Prot:09/07 të datës 22.02.2021 të Komisionit Disiplinor; Njoftimin e datës 15.12.2020, 22.12.2020, 08.01.2021, dhe 31.03.2021 nga Arkivi i ZPRK; E-mailin e datës 22.01.2021 nga M.H për ankuesin; E-mailin e datës 27.01.2021 dhe 23.01.2021 nga ankuesi; Deklaratën e datës 06.04.2021 nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit; Vendimin e datës 26.09.2017 për emërimin e Zëvendësshefit të Stafit të Kabinetit të Presidentit të Kosovës; Listën e pagave janar 2021, dhjetor 2020, shkurt 2021; E-mailin e datës 02.02.2021 nga A.M; E-mailin e datës 29.01.2021 dhe 28.01.2021 nga B.M.K; E-mailin e datës 28.01.2021 nga F.P; Përgjigjen në ankesë të datës 06.04.2021; Kërkesën e datës 08.04.2021 nga ankuesit; Kërkesën e datës 30.04.2021 për shtyrje të afatit për vendosje dhe Vendimin VK.nr.21/2021 të datës 30.04.2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 29.03.2021.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës, si dhe pretendimet ankimore të palës ankuese, ka konstatuar se ankesa A.nr.178/2021 e datës 23.03.2021 e parashtruar nga ankuesi *është e pa bazuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesi me datë 18.06.2018 përmes Vendimit me Nr.prot:733/1 të Presidentit të Republikës së Kosovës, është emëruar Sekretar i Zyrës së Presidentit, sipas dispozitave të nenit 14 paragrafi 5 dhe nenit 16 të Ligjit Nr.03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës.

U.d Presidentja e Republikës së Kosovës, me datë 15.12.2020 përmes shkresës me numër protokollit 1335 ka iniciuar procedurë disiplinore ndaj ankuesit Sekretar i Zyrës së Presidentit, ndërsa me datë 03.02.2021 e njëjta përmes shkresës drejtuar Menaxheres së Personelit në ZPRK, ka konfirmuar iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit, nën supozimin se ankuesi ka bërë shkelje të rëndë të detyrave të punës dhe tejkalim të kompetencave zyrtare të përcaktuara me nenin 17 të Ligjit Nr.03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës, dhe nenin 18 të Rregullores (P) Nr.02/2016 për Strukturën Organizative të Presidencës, sepse i njëjti me datë 06.11.2020 ka ofruar informata të pavërteta për eprorin tij, për kinse bastisje të EULEX-it në Zyrën e Presidentit; Ka hyrë në zyrën e u.d Presidentes bashkë me një person tjetër të pa autorizuar dhe ka tentuar t'i qaset kasafortës së Zyrës së Presidentit.

Lidhur me këtë çështje, U.d Presidentja e Republikës së Kosovës, në përputhje me dispozitat e nenit 49 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe nenin 24 të Rregullores Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, me datë 06.01.2021 përmes Vendimit Nr.01/2021, ka themeluar Komisionin Disiplinor *ad hoc* për Emërime të Larta në kuadër të Zyrës së Presidentit (me tutje Komisioni Disiplinor), ndërsa me datë 20.01.2021, përmes Vendimit Nr.03/2021 ka bërë Plotësimin dhe Ndryshimin e Vendimit Nr.01/2021, duke zëvendësuar një anëtar të Komisionit Disiplinor.

Komisioni Disiplinor pranë Zyrës së Presidentit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, dëgjimit të dëshmitarëve dhe palës ankuese, me datë 22.02.2021 ka nxjerr Vendimin me numër protokollit 09/08 përmes të cilit ka konstatuar se ankuesi është përgjegjës për shkak se i njëjti në cilësinë e Sekretarit të Zyrës së Presidentit, me datë 06.11.2020 ka keq informuar eprorin e tij dhe ka refuzuar të zbatojë urdhrin e u.d Presidentes së Republikës së Kosovës, lidhur me detyrimet që burojnë nga Ligji Nr.03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës, neni 17 pika 1, dhe Rregullorja (P) Nr.02/2016 për Strukturën Organizative të Presidencës, neni 18, pika 2, ku përcaktohet se: *Sekretari drejtpërdrejtë i përgjigjet Presidentit dhe detyrat e tij/saj i kryen në bashkëpunim të ngushtë me Presidentin, si dhe pika 2.2 për sigurimin e informatave të sakta dhe për këshilla të paanshme dhe profesionale për Presidentin.* Komisioni Disiplinor, ka gjetur se veprimet e Sekretarit të Zyrës së Presidentit, me datë 06.11.2020 janë në kundërshtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 26 pika 1 ku përcaktohet se: *Zyrtari publik ka detyrimin të veprorë në përputhje me urdhrat e marrë nga mbikëqyrësit e tij, sipas ligjit dhe rregullave të brendshme të institucionit, si dhe nenin 46 pika 3.10 ku përcaktohet se: shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi, dhe mbi këtë konstatim të njëjtit i është shqiptuar masa disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil".*

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se I.K, ka qenë i përfshirë drejtpërdrejtë në ngjarjen e rastit dhe pjesëmarrja e tij në cilësinë e anëtarit të Komisionit Disiplinor, paraqet konflikt interesi sipas dispozitave të Ligjit Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik; I njëjti konsideron se Vendimi me numër protokollit 09/08 i datës 22.02.2021 i Komisionit Disiplinor, për shqiptimin e masës disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil", është i paligjshëm sepse është nxjerr jashtë afatit të përcaktuar ligjor, prej 30 dite, për faktin se kërkesa për iniciim të procedurës disiplinore është bërë me datë 15.12.2020 ndërsa vendimi për shqiptimin e masës disiplinore nga Komisioni Disiplinor është nxjerr me datë 22.02.2021. Po ashtu, ankuesi pretendon se konstatimet e Komisionit Disiplinor për shkelje të detyrave të punës nuk qëndrojnë



dhe janë të pa bazuara, sepse i njëjti pretendon se në cilësinë e Sekretarit të Zyrës së Presidentit ka përcjell vetëm një informatë zyrtare të marrë nga zyrtari A.A. Zv. Shefi i Stafit të Kabinetit të Presidentit, ndërsa sipas tij kasaforta në Zyrën e Presidentit nuk është hapur, dhe rrjedhimisht nuk është kryer shkelja e supozuar, kështu që ankuesi konsideron se Vendimi me numër protokoll 09/08 i datës 22.02.2021 për shqiptimin e masës disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil", është në kundërshtim me nenin 50 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Andaj, mbi bazën e këtyre rrethanave, ankuesi kërkon të aprovohet si e bazuar ankesa e tij, të anulohet Vendimi me numër protokoll 09/08 i datës 22.02.2021 i Komisionit Disiplinor dhe të obligohet Zyra e Presidentit që të kthejë të njëjtin në pozitën e Sekretarit të Zyrës së Presidentit me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës dhe t'ia kompensojë pagat dhe beneficinet e humbura.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, gjatë administrimit të provave të lëndës, ka gjetur se anëtari i Komisionit Disiplinor, I.K., përmes deklaratës me shkrim ka mohuar se ka qenë pjesëmarrës i drejtpërdrejtë në zhvillimet rreth ngjarjes për të cilën është iniciuar procedura disiplinore. I njëjti pohon se të njëjtën ditë (06.11.2020) është ftuar nga Kryetarja e Kuvendit dhe u.d. Presidentja e Republikës së Kosovës për ta shoqëruar në Zyrën e Presidentit, ku në zyre ishin prezent F.P. dhe D.G. dhe është biseduar për ngjarjen e cila tashme kishte ndodhur. Andaj, duke marrë parasysh deklaratën me shkrim të I.K., përmes të cilës i njëjti mohon kategorikisht se ka qenë i involvuar drejtpërdrejtë në ngjarjen e rastit për të cilën është iniciuar procedura disiplinore, dhe meqenëse në provat e lëndës Kolegji nuk ka gjetur ndonjë shkresë përmes të cilës ankuesi ka kërkuar dorëheqjen e ndonjë anëtari të Komisionit Disiplinor, para vendimmarrjes, siç parashihet me dispozitat e nenit 30 paragrafi 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankuesit në këtë kuptim është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se Vendimi me numër protokoll 09/08 i datës 22.02.2021 i Komisionit Disiplinor, është nxjerr jashtë afatit të përcaktuar ligjor, Kolegji duke u bazuar në shkresat e lëndës, ka gjetur se Udhëheqësja e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në ZPRK, me datë 20.01.2021 përmes emailit zyrtar ka njoftuar anëtarët e komisionit lidhur me përbërjen e plotë të Komisionit Disiplinor, dhe njëherit të njëjtit i ka ftuar në takimin e parë për shqyrtimin e rastit disiplinor, me datë 21.01.2021. Andaj, në kuptim të dispozitave të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, përkatësisht nenit 12 paragrafi 6 ku përcaktohet se: *Komisioni disiplinor duhet të marrë vendim brenda 30 ditëve pas pranimit të kërkesës për iniciim të procedurës nga njësia për burime njerëzore*, si dhe duke u bazuar në nenin 81 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vlerëson se Vendimi me numër protokoll 09/08 i datës 22.02.2021 i Komisionit Disiplinor është nxjerr brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit është i paqëndrueshëm.

Ndërsa lidhur me konstatimet e Komisionit Disiplinor, se ankuesi me veprimet e tij të datës 06.11.2020 ka bërë shkelje të detyrave të punës, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, duke u bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht Ekstraktin e Procesverbalit me numër protokoll 09/5 të datës 10.02.2021, ka gjetur se ankuesi, lidhur me hapjen e kasafortës të Zyrës së Presidentit, në pyetjet e anëtarëve të Komisionit Disiplinor, ka pranuar se *F.P. i ka thënë se Presidentja ka kërkuar që*

kjo çështje shqyrtohet pas dy orësh, ndërsa ankuesi ka thënë se ...me vjen keq se kjo çështje është urgjente. E hapi kasafortën dhe mandej çka boni ju është përgjegjësi e juaja. Por dera nuk është hapur. Sikur të bënte do ta hapja. Andaj, duke marr parasysh këtë konstatim, si dhe konstatimin e Komisionit Disiplinor se Zyra e Presidentit nuk është bastisur nga EULEX-i me datë 06.11.2020, Kolegji analizoje dispozitat e Ligji Nr.03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës, neni 17 paragrafi 1, ku përcaktohet se: Sekretari drejtpërdrejtë i përgjigjet Presidentit dhe detyrat e tij/saj i kryen në bashkëpunim të ngushtë me Presidentin, si dhe paragrafin 2 ku përcaktohet se: Sekretari është përgjegjës për këto çështje: 2.2 për sigurimin e informatave të sakta dhe për këshilla të paanshme dhe profesionale për Presidentin, dhe rrjedhimisht konstatoj se Komisioni Disiplinor, me rastin e përcaktimit të përgjegjësisë disiplinore të ankuesit lidhur me shpërfilljen e urdhrin të eprorit të tij, ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 26 paragrafi 1 dhe nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrat e Publikë, dhe në këtë kuptim pretendimi ankimor i ankuesit është i pa bazuar.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.178/2021**

Avdyl Bektashi



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit,
- Presidentes të Republikës së Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Zyrën e Presidentit; dhe
- Arkivot të KPMSHCK-së.

